



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 127/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në seancën e panelit të mbajtur me 04.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Konstatohen të tërhequra ankesat me numër: Anr.92/2014 dhe Anr.94/2014 të datës 31.05.2014, të parashtruara në PZAP nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Arsyetim

PZAP, me datë 04.06.2014, ka pranuar një kërkesë për tërheqjen e ankesave me numër: Anr.92/2014 dhe Anr.94/2014 të datës 31.05.2014, të parashtruara në PZAP kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën kërkohet që të tërhiqen ankesat e lartpërmendura nga shqyrtimi duke u bazuar në faktin se shkeljet që janë bërë nga subjekti politik politik LDK janë përmisuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesave të sipërhënuara, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos të shqyrtohen ankesat në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP – së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 127/2014 më datën 04.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha